



## Titulli i projektit

Peshkopia qyteti i luleborës dhe trëndafilave (Rivitalizimi i shesheve, rrugëve dhe parkingjeve në Peshkopi).

## Tipi i projektit

Shërbime Publike

## Vendndodhja e projektit

Bashkia Peshkopi

## Buxheti i paravlerësuar

500,000 Euro

## Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Qyteti i Peshkopisë është qendra administrative dhe urbane e Dibrës, ku ndodhin ndërveprimet ekonomike, tregtare, të punësimit dhe të shërbimeve kryesore për të gjithë zonën. Agresiviteti i lartë ekonomik, shoqëror dhe politik i viteve të tranzicionit ka krijuar një kaos në qytet, me ndërtime të shumta pa kriter urbanistik, me rrugë dhe sheshe të zaptuara dhe jashtë funksionit, me trafik të çrregullt dhe mungesë parkingjesh, që krijojnë një pamje të shëmtuar të qytetit.

Cilësia e dobët e shëtitoreve, shesheve, rrugëve, parkingjeve në Peshkopi, në më të shumtën e rasteve vjen edhe për mungesë të rregullit dhe angazhimit institucional dhe qytetar për rregullimin e hapësirave publike, sidomos të atyre që janë para ambjenteve të dyqaneve/shërbimeve të vetë qytetarëve dhe atyre ambjenteve që janë nën administrimin e bashkisë.

Investimet e fundit të KfW për ujësjellësin dhe Bankës Islamike për rregullimin e bulevardit kryesor janë një mundësi e mirë për të rivitalizuar sheshin, rrugët, trotualet dhe transportin urban, duke sistemuar parkingjet dhe stacionet e minibuzeve.

Objekti i përgjithshëm: Përmirësimi i cilësisë së jetës urbane në Peshkopi.

Objekti specifik: Rivitalizimi i pamjes urbane të qytetit të Peshkopisë, duke bërë rikonstrukcionin e shesheve, rrugëve, trotuareve, lulishteve, vend-parkingjeve, sistemin e transportit urban, brenda vitit 2019.

Rezultati i pritshëm 1: Komuniteti i biznesit që ushtron aktivitet në dyqanet/baret/qendrat tregtare në krah të rrugëve të qytetit, është i ndërgjegjësuar dhe kontribuon për mbjelljen dhe përkujdeset për vazot me lulebore, trëndafila dhe bimë të tjera dekorative buzë trotuareve, para objekteve të tyre. Komuniteti i biznesit kontribuon që Peshkopia të bëhet dhe identifikohet si qyteti i luleboreve dhe trëndafilave.

Rezultati i pritshëm 2: Peshkopia me shëtitore dhe sheshe të rregulluara. Bulevardi kryesor, i cili rregullohet me investimin e Bankës Islamike, zgjatet deri tek Ura e Pazarit, ku ndërtohet monumenti i harkut të qytetit.

# PROJEKTI 7



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

- 1 Dialogimi me bizneset dhe qytetarët
- 2 Shtrimi i rrjetit vaditës
- 3 Mbjellja e luleve  
Rehabilitimi i shesheve dhe shëtitoreve
- 4 Sistemimi i shëtitores së bulevardit kryesor
- 5 Sistemimi i sheshit Bajram Curri, me shëtitore në mes dhe kalim makinash në dy anët.
- 6 Ndërtimi i monumentit të harkut të qytetit tek Ura e Pazarit  
Sistemimi i parkingjeve dhe stacionit urban.
- 7 Sistemi i stacionit tek ambientet e tregut fshatar
- 8 Përcaktimi i parkingjeve

## Maturimi i projektit

Bashkia Peshkopi aktualisht po përfundon planin urban. Për shumicën e këtyre ideve ekzistojnë projektet, një pjesë e të cilëve janë në zbatim, si ato me KfW dhe Bankën Islamike.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Bashkia e Peshkopisë është aktori kryesor për hartimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e këtij programi. Partner në program janë donatorët, aktualisht KfW dhe Banka Islamike. Bashkia do të bashkëpunojë ngushtë me komunitetin dhe me OJF, për të lehtësuar këtë proces.

## Kostot e projektit

Kostoja për zbatimin e këtij programi është 500,000 Euro.